

## **Letër pozicionimi për çështjen e AJRIT**

### **I. Hyrie**

Kjo letër pozicionimi u drejtohet: Parlamentarëve, Pushtetit vendor dhe qendror, Institucioneve publike/shëndetësore, Biznesit (Dhoma e Tregtisë) dhe Institucioneve ndërkombëtare dhe shpreh mendimin dhe dëshirën e OJF-ve, Intelektualëve, Qytetarëve dhe Medias për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit nëpërmjet arritjes së standardeve si pjesë e cilësisë së jetës.

Spektori i OJF-ve mjedisore në Shqipëri identifikon si domosdoshmëri informimin e publikut për situatën aktuale lidhur me ajrin urban dhe ndërgjegjësimin e publikut për t'i adresuar çështjet e ajrit urban tek vendimmarrësit e institucionet ndërkombëtare, dhe për të ushtruar presion ndaj tyre lidhur me respektimin e normave kombëtare dhe europiane të ndotësve të ajrit, me qëllim që të ndërmerren masat e duhura ligjore, administrative, teknologjike, për të arritur sigurimin e përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe të jetës, si dhe të standardeve përkatëse.

Në takimin e Dhjetorit 2006<sup>1</sup> të OJF-ve mjedisore u identifikua si përparësi e sektorit kërkesa dhe mbështetja ndaj qeverisë në përmbushjen e detyrimeve ligjore përsa i përket zgjerimit të monitorimit dhe informimit të rregullt (jo më pak se cdo 3 muaj) të publikut të gjerë në lidhje me përqendrimet e disa treguesve (O<sub>3</sub>; SO<sub>2</sub>; NO<sub>x</sub>; CO; Lëndët e Ngurta Pezull, dhe Pb). Në vijim të kësaj nisme, OJF-të gjatë Takimit Kombëtar të Dhjetorit 2008, mandatuan një grup pune i cili mban rolin e sekretariatit të OJF-ve mjedisore.

Takimet e sekretariatit janë lehtësuar nga Milieukontakt dhe janë shfrytëzuar informacionet mbi praktikat më të mira Evropiane marrë me anë të kontakteve me rrjetet përkatëse të OJF-ve. Letra e pozicionimit do të shërbejë si platformë veprimi për hartimin e fushatave për OJF-të mjedisore që synojnë përmirësimin e cilësisë së Ajrit, që të gjithë ne të jetojmë me dinjitet njerëzor në një mjedis të shëndetshëm.

### **II. Situata aktuale**

Sipas raportit të Gjendjes në Mjedis 2005-2007 të Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për monitorimin e ajrit, cilësia e ajrit në qendrat e mëdha urbane rezulton si më poshtë:

- ↳ Edhe pse përqendrimet e Lëndëve të Ngurta Pezull (LNP) kanë qenë në rënie vitet e fundit, ato janë problematike, sepse përqendrimet e tyre referuar monitorimit të ISHP, vazhdojnë të jenë mbi normat e lejuara shqiptare dhe mbi ato të BE-së.

---

<sup>1</sup> Takimi i 6të Kombëtar i shoqatave mjedisore Shqiptare

- ↳ Treguesit e tjerë (SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub>, Pb) rezultojnë brenda normave të lejuara të Standardit Shqiptar dhe të BE-së për të gjitha stacionet e monitoruara, por me tendencë në rritje të përqendrimeve të tyre, nëse krahasohen të dhënat e matjeve për disa vite radhazi.
- ↳ Bazuar në po të njëjtin raport mbetet problematike ndotja akustike në zonat urbane ku banon mbi 30% e popullsisë e ku qarkullojnë mbi 60% e automjeteve.
- ↳ Po kështu në raport nuk jepen të dhëna të sakta për sasinë e shpyllëzimeve, por deklarohen shifra të inventarizimit të para 50 viteve. Megjithatë nga inventarizimi dhe studime të ndryshme të Bankës Botërore<sup>2</sup> rezulton se janë katastrofike dëmet në pyje nga aktivitetet ilegale, zjarret, tjetërsimi i sipërfaqes pyjore në toka me destinacione të tjera, dhe moszbatimi i legjislacionit, me pasoja të rënda në prishjen e ekuilibrave ekologjike.

### **III. Analiza e situatës**

Katër janë faktorët e ndotjes së ajrit: rritja e qyteteve, moszbatimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në biznes, konsumi i rritur i energjisë nga lëndët djegëse fosile (qymyr, naftë, etj) dhe shtimi i trafikut rrugor.

Nivelet e larta të ndotjes vijnë si rezultat i:

- ✘ Moszbatimit të teknologjisë moderne në prodhim dhe në kontrollin pa ndërprerje të ndotësve të ajrit;
- ✘ Cilësisë së dobët të karburanteve
- ✘ Shërbimit jokonkurrues e jo komod të transportit publik
- ✘ Keqplanifikimit urban në qytetet tona
- ✘ Korrupsionit në institucionet që merren me menaxhimin dhe monitorimin e ndotësve të mëdhenj apo të mesëm të ajrit;
  - Kontradiktës mes ligjit dhe zbatimit të tij;
  - Nivelit të ulët të kualifikimit dhe mungesës së përgjegjshmërisë të punonjësve në sektorin e ajrit (Emërimeve politike në kurriz të profesionalizmit);
- ✘ Keqmenaxhimit të pyjeve dhe pakësimit të sipërfaqeve dhe kurorave të gjelbra në zonat e banuara;
  - Djegia e mbetjeve urbane
- ✘ Përdorimit të gjeneratorëve për prodhimin e energjisë
- ✘ Moszbatimit të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm;
  - Nivelit të ulët të përfshirjes së komponentëve mjedis dhe shëndet në politikat për transportin, planifikimin hapësinor e urban;
- ✘ Nivelit të ulët të ndërgjegjësimit mjedisor tek vendimmarrësit dhe publiku;

---

<sup>2</sup> Projekti ANFI

#### **IV. Konkluzione**

Shqetësohemi për ajrin, sepse ndotja e tij ul jetëgjatësinë e popullsisë, rrit sëmundshmërinë sidomos të femijeve dhe grupeve vunerabel si dhe ul cilësinë e jetës.<sup>1</sup>

Edhe pse situata është e njohur nga pushtetarët e të gjitha ngjyrave politike që kanë qenë e janë në pushtet, koha ka treguar se është bërë pak në mënyrën e trajtimit të çështjes jetike të ajrit që e thithim të gjithë njësoj, me një indiferencë të paparë!

MMPAU është përgjegjësja kryesore për gjendjen aktuale mjedisore.

#### **V. KERKESA të shoqërisë civile**

Ne anëtarë të shoqërisë civile, me qëllim që ***të mos vonohet asnjë çast më tepër ngritja në nivel mbarëkombëtar e shqetësimit të të gjithëve për rritjen e cilësisë së ajrit urban në vendin tonë, brenda një afati 5 vjeçar kërkojmë:***

- Uljen e shkarkimeve të ndotësve problematikë në ajër (LNP, PM<sub>10</sub>) brenda normave shqiptare dhe në përputhje me direktivat e BE-së;
- Të shtohen matjet e treguesve të ndotjes së ajrit në përputhje me kërkesat e BE-së.
- T'i jepet përparësi zvogëlimit të ndotjes së ajrit nga transporti dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare;
- Mbështetja nga qeveria me fushata për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe vendim marrësve mbi efektet dëmtuese të ndotjes së ajrit në shëndetin e njerëzve dhe veçanërisht të fëmijëve.
- Shtimin e sipërfaqeve dhe kurorave të gjelbra në zonat e banuara mbi bazën e studimeve dhe planeve të sakta strategjike me synim arritjen e normave europiane;
- Forcimin e luftës kundër korrupsionit në organet qeverisëse të lidhura direkt me cilësinë e ajrit (profesionalizëm dhe ndërgjegjshmëri të lartë; stop emërimeve politike)
- Ndalimin e shpyllëzimeve apo tjetërsimeve të sipërfaqeve pyjore;
- Forcimin e masave të luftës kundër zjarreve;
- Përmirësimin e forcimit dhe zbatimit të legjislacionit mjedisor shqiptar
- Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Pyjeve lidhur me shfrytëzimin e lëndës drusore me karakter tregtar;
- Harmonizimin e interesave të komunitetit, biznesit dhe vendimmarrësve në nivel vendor dhe qendror;
- Përfshirja e komponentëve të mjedisit dhe shëndetit në politikat e qëndrueshme të transportit e planifikimit urban në të dy nivelet: kombëtar dhe lokal.

---

<sup>1</sup> Bazuar ne studimet e OBSH: "Në Bashkimin Evropian nga ndotja e ajrit me përqendrimet e lendeve (PM) jeta e çdo personi ulet mesatarisht 8,6 muaj". (Raporti i 2005)